VENDIM
Nr. 320, datë 12.12.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBSOLAR" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK "ALBSOLAR PV PARK 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/5 prot., datë 7.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Albsolar' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik 'Albsolar PV Park 1', me kapacitet të instaluar 2 mw, në Bisht Kamzë, Bashkia Durrës",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 10.11.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Albsolar" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Albsolar PV Park 1", me kapacitet të instaluar 2 mw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 12.11.2022 dhe 14.11.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1874/4 prot., datë 18.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Po ashtu me shkresën nr. 1874/3 prot., datë 17.11.2022 ERE i është drejtuar edhe MIE-s duke i kërkuar që brenda 10 ditëve nga marrja dijeni e shkresës të japë qëndrimin e saj mbi sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 8.11.2022, që licenca e prodhimit t'i lëshohet shoqërisë "Albsolar" sh.p.k. Deri më sot nuk rezulton të jetë përcjellë në ERE qëndrimi i MIE-s për sa kërkuar, ndaj vlerësohet vijimi me vendimmarrjen përfundimtare të ERE-s për sa shprehur nga Bashkimi i shoqërive me vullnet të lirë, duke lënë mundësinë e rishikimit të vendimit të licencimit në rast se MIE do të shpreh qëndrimin e saj.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Albsolar" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe nenit 5, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga se deklaruar nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Albsolar" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Albsolar Pv Park 1, me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25-vjeçar.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në vijim të qëndrimit të MIE-s për sa vendosur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive në vendimin e datës 8.11.2022, që licenca e prodhimit t'i lëshohet shoqërisë "Albsolar" sh.p.k.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti